



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM

NJOFTIM PER MEDIA

Referuar raportimeve të mëparshme në media, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, informon sa më poshtë:

Më datë 15.12.2022, është njoftuar Salla Operative e Policisë Tiranë se në Rrugën e “Kosovarëve”, tek pallati “Orion”, është vjedhur banesa e shtetases me iniciale **A. K.** Për kryerjen e kësaj vepre penale, është akuzuar pastruesja e saj me iniciale **R. D** si dhe djali i kësaj të fundit me iniciale **H. D.**

Në përfundim të hetimeve paraprake Prokurirsa pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, paraqiti kërkesën, me objekt:

1. *Dërgimin në gjyq të procedimit penal nr. 9220/2022, kundër:*

- (i) të pandehurës me iniciale **R. D.**, e akuzuar për kryerjen e veprave penale të **“Vjedhjes”** me pasoja të rënda, në bashkëpunim dhe **“Vjedhjes”** më shumë se një herë, parashikuar nga nenet 134/3 - 25 dhe 134/2 të K. Penal,
- (ii) të pandehurit me iniciale **H. D.**, i akuzuar për kryerjen e veprës penale të **“Vjedhjes”** me pasoja të rënda, në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 134/3 – 25 të Kodit Penal,
- (iii) të pandehurës me iniciale **A. K (Ç)**, e akuzuar për kryerjen e veprës penale të **“Refuzimi për deklarin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”**, parashikuar nga neni 257/a/2 të Kodit Penal.

2. Pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. 9220/2022 për veprat penale **“Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”** dhe **“Deklarata e rreme përpara oficerit të policisë gjyqësore”**, parashikuar nga nenet 287/1 dhe 305/b të Kodit Penal, ndaj personit nën hetim **A. K (Ç)**.

I. Në lidhje me kërkesën për pushim si më sipër treguar, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, (gjyqtari i seancës paraprahe) **me vendimin datë 04.03.2024 ka vendosur:**

- Pranimin pjesërisht të kërkesës së prokurorisë.
- Pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. 9220 të viti 2022 me person nën hetim **A. K (Ç)**, për veprën penale **“Deklarata e rreme përpara oficerit të policisë gjyqësore”**, parashikuar nga neni 305/b të Kodit Penal.
- Kthimin e akteve për veprën penale **“Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”**, parashikuar nga neni 287/1 të Kodit Penal, ndaj personit nën hetim **A. K (Ç)**.

Ndaj këtij vendimi, ka bërë ankim:

*-Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, e cila ka kërkuar ndryshimin pjesërisht të vendimit. Pushimin e hetimeve për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287/1 të Kodit Penal, ndaj personit nën hetim **A. K (Ç)**.*

*- Personi nën hetim **A. K (Ç)**, e cila kërkoj prishjen pjesërisht të vendimit. Pushimin e gjykimit për kryerjen e veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287/1 të Kodit Penal.*

Ankimet e mësipërme janë në pritje për gjykim, pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

II. Në lidhje me kërkesën për gjykim, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, është gjykuar çështja penale ndaj tre të pandehurve **R. D, H. D dhe A.K (Ç)**.

Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin **nr. 665, datë 19.03.2024 ka vendosur:**

1. Deklarimin fajtores të të pandehurës **R. D** për kryerjen e veprës penale **“Vjedhja”**, parashikuar nga neni 134/3 i Kodit Penal dhe në bazë të kësaj dispozite dënimin e saj me **6 (gjashtë) vjet burgim.**

2. Deklarimin fajtores të të pandehurës **R. D** për kryerjen e veprës penale **“Vjedhja”**, parashikuar nga neni 134/2 i Kodit Penal dhe në bazë të kësaj dispozite dënimin e saj me **1 (një) vit burgim.**

3. Në bazë të nenit 55 të Kodit Penal, bashkimin e dënimeve në një dënim të vetëm prej **7 (shtatë) vjet burgim.**

4. Në bazë të nenit 406 të K.Pr. Penale, i ulet 1/3 e masës së dënimit dhe e dënon përfundimisht të pandehurin **R. D** me **4 (katër) vjet e 8 (tetë) muaj burgim**.
5. Vuajtja e dënimit i fillon të pandehurës **R. D** nga data e arrestimit në flagrancë datë 07.01.2023
6. Vuajtja e dënimit të vuhet nga e pandehura **R. D** në një burg të sigurisë së zakonshme.
7. Deklarimin fajtor të të pandehurit **H. D** për kryerjen e veprës penale “*Vjedhja*”, parashikuar nga neni 134/3 i Kodit Penal dhe në bazë të kësaj dispozite, dënimin e tij me **5 (pesë) vjet burgim**.
8. Në bazë të nenit 406 të K.Pr. Penale, i ulet 1/3 e masës së dënimit dhe e dënon përfundimisht të pandehurin **H. D** me **3 (tre) vjet e 4 (katër) muaj burgim**.
9. Vuajtja e dënimit i fillon të pandehurit **H. D** nga data e ndalimit datë 07.01.2023
10. Vuajtja e dënimit të vuhet nga i pandehuri **H. D** në një burg të sigurisë së zakonshme.
11. Deklarimin fajtor të të pandehurës **A. K (Ç)** për kryerjen e veprës penale “*Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim*” parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal dhe në bazë të kësaj dispozite dënimin e saj me **2 (dy) vjet e 6 (gjashtë) muaj burgim**.
12. Në bazë të nenit 406 të K.Pr. Penale, i ulet 1/3 e masës së dënimit dhe e dënon përfundimisht të pandehurën **A. K (Ç)** me **1 (një) vit e 8 (tetë) muaj burgim**.
13. Vuajtja e dënimit i fillon të pandehurës **A. K (Ç)** nga data e ndalimit datë 07.02.2023.

...

Ndaj vendimit kanë bërë ankim:

- *E pandehura me iniciale A. K (Ç), e cila kërkoi ndryshimin e vendimit, deklarimin e pafajshëm.*
- *E pandehura me iniciale R. D, e cila kërkoi ndryshimin e vendimit, dhënien e një dënimi më të butë.*
- *I pandehuri me iniciale H. D, i cili kërkoi ndryshimin e vendimit. Deklarimin fajtor për veprën penale të “Vjedhjes” dhe aplikimin e nenit 406 të K.Pr. Penale. Në zbatim të nenit 59 dhe 60/9 të Kodit Penal, pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim për pjesën e pavuajtur të dënimit, duke e vënë në provë të pandehurin.*

Në përfundim të gjykimit, më datë 02.10.2024, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, e përbërë nga trupi gjykues me Relatore Gjyqtare z. Fuat Vjerdha dhe anëtare z. Genti Shala dhe z. Genti Dokollari, vendosi:

- Lënien në fuqi të vendimit Nr. 665, datë 19.03.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

GJYKATA E APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM